

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, kryetari i trupit gjykues BeqirKalludra, gjyqtarët Shashivar Hoti dhe SuzanaQerkiniantarë të trupit gjykues, me bashkëpunorin profesional Driton Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarve H.B.dhe B.Z., për shkak të veprës penale secili veç e veç Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të rënda PP/I.nr.55-11/12, të dt.28.03.2013, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, në të cilën kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Feti Tunizliu, i akuzuari H.B.dhe mbrojtësi i tij av.M.N., sipas autorizimit, i akuzuari B.Z., dhe mbrojtësi i tij av.N.P. sipas autorizimit, me dt.14.05.2018mori, dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari H.B., ngai ati Z. dhe nëna Xh., e vajzërisë B.1, i lindur më ..., në fshatin G., komuna e K. me vendbanim në L. e R. në H., Komuna e P.1, i martuar, baba i ... fëmijëve, doktor në shkencat ekonomike, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I akuzuari H.B.si person zyrtar, udhëheqës i politikave turistike dhe promocion turistik në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), nuk e ka përmbushur detyrën e tij zyrtare si bartës i projektit-m. ‘Navigatori i qytetit’ në atë mënyrë që, me qëllim të përfitimit kundërligjor për kompaninë ‘A.C.’ nga Gj., ia ka mundësuar pagesën e tërësishme të shumës prej 113.013,00 Euro, nga kontrata ‘Furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve për navigator të qytetit’, e dt.01.10.2008, përkundër faktit se kjo kompani ka përmbushur vetëm pjesërisht obligimin me furnizimin e MTI-së me pajisjet të parapara në kontratë, derisa kompania ‘A.C.’ paraprakisht kishte pranuar në emër të avansit, shumën prej 22.602,60 euro, duke i mundësuar përfitim pasuror të kundërligjshëm kompanisë‘A.C.’,

- me këtë ka kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së.

Prandaj, gjykata konform dispozitave 2, 4, 50, 51 lidhur me 45, 73 dhe 74 të KPRK-së, si dhe nenet 359, 365, 366, 368, 450, 453 dhe 463 të KPRK-së, e:

GJYKON

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatj prej 1 (një) viti, icilidënimnuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti i akuzuari nuk kryen vepër tjetërpenale.

Detyrohet i akuzuari që t’i paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërkaq në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 200 (dyqind) euro, të cilën shumë duhet t’a paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara përfaqësuesja e autorizuar e Ministrisë së Drejtësisë për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari B.Z., nga i ati B.2 dhe nëna A., e vajzërisë Sh., i lindur më ..., në fshatin R., komuna e P.2, tani me vendbanim në P.3, lagjiaV., rruga H.H. pn., i martuar, baba i ... fëmijëve, ka të

kryer fakultetin ekonomik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së,

LIROHET NGA AKUZA

Sepse:

I akuzuari B.Z. si person zyrtar, m. i prokurimit në MTI, nuk e ka përmbushur detyrën e tij zyrtare në atë mënyrë që me dt.19.12.2008, ka lëshuar urdhër për pagesa me vlerë prej 90.410,00 euro, për kompaninë "A.C." nga Gj., të cilës kompani paraprakisht me dt.17.10.2008, i është paguar avans në shumë prej 22.602,60 euro, duke ia paguar në këtë mënyrë asaj kompanie shumë në tërësi prej 113.013,00 euro nga kontrata "Furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve për navigator të qytetit", me nr.MTI 204-08-064-1.1.1 të dt.01.10.2008, përkundër faktit se kjo kompani nuk i ka përmbushur të gjitha obligimet nga kontrata, duke i sjellë kësaj kompanie përfitim pasuror të kundërligjshëm,

- me këtëkishtepërtëkryerveprënpenele Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, konform nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria themelore në Prishtinë – Departamenti për Krimet të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.55-11/12, të dt.28.03.2013 kundër të akuzuarve H.B.dhe B.Z.për shkak të veprës penale penale secili veç e veç,Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, kjo Gjykatë ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, dhe pas leximit të aktakuzës, të akuzuarit H.B.dhe B.Z. kanë deklaruar se nuk e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar. Meqë të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë për këtë vepër penale, gjykata duke u bazuar në nenin 327 të KPRK-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdojë me fjalën hyrëse dhe prezantimin e provave.

Prokurori i shtetit Feti Tunizliu në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruargojarisht ka theksuar se nga provat e administruara është vërtetuar në tërësi gjendja faktike e përshkruar si nëdispozitivin e aktakuzës, dhe se kjo gjendje është vërtetuar nga ekspertiza financiare, pastaj nga dëshmitë e dëshmitarëve A.S., N.Sh., A.K., B.K.dhe B.H.. Andaj në këtë gjendje të vërtetuar faktike, të akuzuarit janë penalisht përgjegjës pasi që veprimet inkriminuese i kanë kryer me dashje direkte dhe me qëllim qëoperatorit ekonomik "A.C.", t'i sigurojnë përfitime financiare të kundërligjshme, dhe në të njëjtën kohë i kanë shkaktuar dëm financiar MTI, ndërsa që nuk është vërtetuar se të njëjtit kanë vepruar në realizimin e ndonjë urdhëri nga lartë, mirëpo edhe në këtë rast të njëjtit e kanë ditur apo është dashur ta dijnë, nisur nga përvoja e punës dhe niveli i arsmimitse urdhërat e tillë janë të paligjshëm, dhe si të tillë nuk duhet zbatuar. Andaj ka kërkuar nga gjykata që të njëjtit t'i shpall fajtor dhe t'i dënoj sipas dispozitave ligjore në fuqi, ndërsa që me rastin e matjes së dënimit, t'i marrë parasysht rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke ua shqiptuar nje dënim i cili do të jetëporporcional me përgjegjësinë penale të të njëjtëve, dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprimeve inkriminuese të të njëjtëve.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.B., av. M.N., në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, ka pretenduar se me provat e administruara nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij e ka kryer veprën penale për kryerjen e të cilës është akuzuar, dhe se për më tepër në vet dispozitivin e aktakuzës nuk janë përshkruar veprimet inkriminuese të të mbrojturit të tij. Më tutje ka shtuar se dëshmitari A.S., gjatë dëshmisë së tij në shqyrtim gjyqësor, po ashtu edhe në deklaratat që ka dhënë në procedurë paraprake në shumë drejtime ka qenë kontradiktor dhe i paarsyeshëm, ashtu që në deklaratën që ka dhënë në polici, ka deklaruar se kontrata e lidhur ndërmjet firmës së tij dhe MTI-së lidhur me projektin “Navigatori i qytetit”, është dashur të përmbushet në katër pika dhe në dy faza, ndërsa që faza e dytë nuk është përmbushur, për shkak se MTI-ja nuk ka arritur t’iu sigurojë instalimin e kabinave dhe lidhjen e tyre me rrjetë dhe rrymë, dhe se kontaktet i ka zhvilluar me sekretarin permanent I.K., B.K. dhe H.B., por që ndërkohë i njëjti është larguar për t’u zëvendësuar me H.S., dhe se në këtë drejtim vërtetohet se i mbrojturi i tij nuk ka qenë i angazhuar deri në përfundim të projektit, ani pse pretendon se kjo ka qenë për faktin se i njëjti nuk ka qenë konstruktiv gjatë realizimit të projektit, dhe për më tepër ana tendencioze e dëshmisë së këtij dëshmitari, rezulton edhe nga pohimi i tij se kinse i mbrojturi i tij ka kërkuar para për magistraturë, e që në të vërtetë i njëjti ka pas të përfunduar këtë nivel studimi. Më tutje ka shtuar se edhe nga dëshmitë e dëshmitarve tjerë, po ashtu edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve B.H., B.K. dhe N.Sh., vërtetohet rrethana se lidhur me të mbrojturin e tij, nuk ka pasur një vendim që i njëjti të caktohet në cilësinë e projekt menaxherit në kontratën e lartëcekur, dhe se në të vërtetë lidhur me realizimin e kësaj kontrate, nuk ka pasur fare projekt menaxher apo organ mbikqyrës, se i njëjti nuk ka insistuar apo ndikuar që t’i bëhen pagesat operatorit, dhe nuk ka vënë kurrfarë vlerësimi sa i përket përmbushjes në tërësi të projektit, si kusht për bartjen e tërësishme të pagesave, po ashtu sekretari permanent ka formuar një komision të veçantë, i cili ka dhënë leje për kryerjen e pagesës në tërësi. Po ashtu edhe sa i përket provave materiale, nga administrimi i të njëjtave nuk është vërtetuar asnjë veprim inkriminues në drejtim të veprës penale për kryerjen e të cilës është akuzuar nga organi i akuzës. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të njëjtin t’a lirojë nga akuza në mungesë të provave lidhur me fajësinë e tij.

I akuzuari H.B. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se që nga viti 2002 punon në MTI, ndërsa që në vitin 2007 e deri në vitin 2014 ka punuar në cilësinë e udhëheqësit të divizionit të politikave turistike dhe të marketingut në kuadër të departamentit të turizmit dhe sa i përket projektit “Navigatori i qytetit” ka theksuar se ka qenë një projekt i cili është iniciuar nga stafi i departamentit në funksion të promovimit të zhvillimit të turizmit në Kosovë e me qëllim të vendosjes së zyrave për informacion turistik, përpilimi i dosjes sëtënderitëshe të bërë nga departamenti i prokurimit dhe ai nuk ka marrë pjesë as në hapjen e ofertave e as në përzgjedhjen OE-së për realizimin e këtij projekti, ndërsa që departamenti i turizmit ka dhënë vetëm sygjerime profesionale rreth projektit. Më tutje ka shtuar se zyrtarisht nuk ka qenë i caktuar si mbikqyrës apo projekt-menaxher i këtij projekti, ndërsa që në fund të muajit nëntor të vitit 2008 drejtori i departamentit të turizmit B.K. në një komunikim të me sekretarin permanent Ibrahim Krasniqi përmes Outlook-ut – formë zyrtare kjo e komunikimit, i ka propozuar emrin e tij si menaxher i këtij projekti dhe i njëjti e ka miratuar një propozim të tillë, ndërsa që i vetë i akuzuari ka shkruar te drejtori B.K. dhe ka kërkuar sqarime lidhur me këtë duke i thënë se menaxheri i projektit caktohet në fillim të realizimit të tij dhe jo në përfundim si në këtë rast dhe po ashtu drejtori B.K. pas një kohe përmes Outlook-ut i ka kërkuar që të raportojë lidhur me projektin në cilësinë e menaxherit të projektit, ndërsa që ky i është përgjigjur se askush nuk e ka caktuar në këtë cilësi dhe se po ashtu edhe në rast kur i ka shkruar lidhur me projektin drejtori i sapoardhur i departamentit N.Sh., përsëri ka kërkuar vendim me shkrim që është menaxheri i projektit dhe se asnjëherë nuk e ka pranuar këtë detyrë mirëpo vetëm ka kryer punë teknike dhe konsultime të kohëpaskohshme profesionale. Më tutje ka shtuar se lidhur me këtë projekt nuk ka pasur të caktuar një projekt-menaxher vërtetohet edhe nga komisioni i brendshëm i formuar për vlerësimin e gjendjes së projektit ku konstatohet se asnjëherë nuk ka pasur të caktuar projekt-

menaxher lidhur me këtë projekt dhe se po ashtu nuk ka qenë asnjëherë i caktuar që të bëjë ndonjë nënshkrim për pranim të mallit sepse në kuadër të ministrisë është komisioni për pranimin e mallrave për nevojat e ministrisë dhe se nga ai vetëm është kërkuar që të jetë prezent gjatë pranimin të mallit dhe se ai nuk e ka nënshkruar raportin e projektit, ndërsa që kur është ballafaquar me raportin e pranimin me dt: 19.12.2008 të cilin i njëjti e ka nënshkruar, është përgjigjur se kjo ka ndodh për shkak se ka qenë prezent në momentin kur kanë ardhur pajisjet në ministri dhe thjeshtë ka konstatuar një gjendje faktike, dhe kjo nuk nënkupton që përmes atij konstatimi është pranuar se kontrata është përmbushur në tërësi dhe se sipas tij kjo kontratë nuk është përmbushur dhe se ai nuk e di se cila ka qenë arsyeja e pagesës nga zyrja e prokurimit. Ndërsa në deklaratë që ka dhënë në procedurën paraprake gjegjësisht në deklaratën e dhënë në polici 16-17.01.2011 të dhënë në cilësinë e dëshmitarit dhe në deklaratën e dhënë në polici 03.10.2012. lidhur me disa rrethanë ka dhënë përgjigje me njëpërmbajtjetjeter. Kështunë deklaratë e dhënë në polici 16-17.01.2011 e ka mohuar se ka qenë në cilësinë e projekt-menaxherit në projektin “Navigatori i qytetit” mirëpo e ka pranuar se është propozuar nga drejtori B.K.dhe në mënyrë elektronike kjo është konfirmuar nga sekretari permanent I.K., mirëpo që lidhur me këtë propozim respektivisht miratim nuk e ka kundërshtuar në mënyrë të shkruar, kjo pasi që i është thënë se do të përpilohet vendim i shkruar ku ai do të emërohet në cilësinë e projekt- menaxherit. Ka deklaruar se ka poseduar kontratën dhe atë ia ka sjellë në zyre drejtori B.K.duke i thënë se kjo është kontrata e “Navigatorit të qytetit” dhe merre ta kesh, dhe se roli i tij në kuadër të këtij projekti ka qenë kujdesi për ecurinë e aspekteve teknike të funksionalizimit të projektit siç janë kontaktet me komunitat, K., P.4. Sa i përket funksionalizimit të projektit nuk është bërë ndonjë valorizim lidhur me përqindjen e zbatimit të kontratës, por që vendosja e kiosqeve të informimit nuk është bërë pasi që OE kiosqet i ka sjellur me llamarinë të plastifikuar ndërsa që është dashur ti sjellë të alumintë dhe me xhama të tejdukshëm. Ndërsa qënë deklaratën e dhënë në polici me dt:03.10.2012 ka deklaruar se ai ka përpiluar projektin ideor “navigatori i qytetit”, se i ka bërë specifikat teknike të tenderit në bashkëpunim me stafin e divizionit, dhe se nuk ka marrë pjesë në përpilimin e kontratës mirëpo e njëjta është përpiluar në bazë të projektit që ka paraparë tri fazat e realizimit të të njëjtit, e që janë furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve. Po ashtu, ka shtuar se në fillim të vitit 2009 operatori ekonomik ka filluar me vendosjen e kiosqeve sa i kujtohet janë vendosur 8 apo 9 kiosqet dhe se ai bashkë me punëtorët kanë shkuar me operatorët ekonomik në pikat e ndryshme dhe kanë konstatuar se psh. në P.3 janë vendosur 3 kabina dhe po ashtu kabina janë vendosur edhe në vende tjera ku është paraparë dhe se gjatë kohës e ka vërejtur se operatori ekonomik nuk është duke i kryer obligimet sipas kontratës, ka intervenuar disa herë duke e informuar drejtorin B.K.dhe po ashtu ka kontaktuar edhe pronarin e kompanisë A.S.n i cili i ka premtuar se do ti përmbushë obligimet e tij.Në fjalën përfundimtare ka pohuar se mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësittë tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.Z., av. N.P., në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar shkurtimisht me gojë, ka theksuar se nga provat e administruara nuk është vërtetuar se në veprimet e mbrojturit të tij, manifestohen elementet e veprës penale Keqpërdorim i pozitës dhe autoritetit zyrtar nga neni 422 i KPRK-së, pasi që nga këto prova, vërtetohet se i njëjti i ka kryer detyrat e tij në cilësinë e zyrtarit të prokurimit ka bërë pagesën e shumës 90.410.00 euro, dhe se kjo shumë është paguar pasi që komisioni kishte pranuar mallin në vlerën e faturës, dhe se i mbrojturi i tij kishte për detyrë pranimin e faturave në pranim me kushtet e kontratës, ndërsa që zyrtari i prokurimit- menaxheri në aktivitetin e prokurimit, nuk mbanë përgjegjësi për pagesat sipas kontratave, dhe se i njëjti është i obliguar që të bëjë pagesën e çdo fature të vlefshme për pagim për mallra dhe shërbime të furnizuara. Andaj nga faktet e vërtetuara nga dosja e tenderit, provohet pakontestueshëm fakti se i mbrojturi i tij ka proceduar mëtej për pagesë, faturën e cila kishte të bashkangjitur të gjitha dokumentet që vërtetonin vlefshmërinë e saj për procedim të mëtejshëm.

I akuzuari B.Z.në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar se ka punuar në MTI në cilësinë e udhëheqësit të zyrës së prokurimit, në periudhën kohore 11.09.2008 deri më dt. 10.01.2009, ndërsa në kohën kur ai ka ardhur me cilësinë e lartcekur, projekti (Navigatori i qytetit) ka qenë në fazën e vlerësimit përfundimtar, ai ka qenë nënshkruar i kësaj kontrate vlera e të cilës ka qenë 113.013,00, dhe se sipas kontratës pagesa është paraparë të bëhet me dy këste. Kësti i parë ka përfshirë 20% të vlerës totale të kontratës, ndërsa që pjesa e mbetur prej 80% është dashur të paguhet pas përbushjes së kontratës. Më tutje ka shtuar se operatori ekonomik me rastin e paraqitjes së ofertës, ka dorëzuar edhe planin dinamik të punës sipas të cilit kontrata është paraparë të përfundohet brenda 9 muajve, dhe se sipas kontratës pajisjet është dashur të dorëzohen në MTI, dhe të njëjtat janë pranuar nga komisioni për pranim teknik dhe janë vërtetuar nga personat tjerë përgjegjës, që është kusht për procedimin me pagesa që ka qenë edhe detyrë e tij në cilësinë e udhëheqësit të zyrës së prokurimit, e që ka të bëjë me lëshimin e urdhërblereve, ndërsa që pagesën e aprovon zyrtari kryesor administrativ i cili në MTI ka qenë sekretari permanent, dhe se edhe në rastin konkret është proceduar në këtë mënyrë. Po ashtu ka shtuar se në dosjen e tenderit dhe në kontratë nuk është cekur që pajisjet duhet të vendosen nëpër pika të caktuara në Kosovë, dhe se kontrata parasheh që vlera e furnizimeve është vlera që është cekur në kontratë, ndërsa që vendosja e pajisjeve ka mundur të jetë vetëm një marrëveshje gojore të cilën ai e ka dëgjuar prej të tjerëve, mirëpo që ai nuk ka parë asnjë shkresë ku të jetë evidentuar një detyrim i tillë. I njëjti edhe në deklaratat që ka dhënë në polici me dt. në cilësinë e dëshmitarit, dhënë prokurori me dt.17.09.2012, është përgjegjës në mënyrë të ngjashme lidhur me rrethanat që është pyetur. Ndërkaq në fjalë përfundimtare ka pohuar se mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Pas procedimit të provave në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të dëshmitarëve A.S., A.K., B.K., B.H. dhe N.Sh., si dhe nga provat materiale, kontrata nr.MTI204-08-064-1.1.1 me titull “Furnizimi, Instalimi dhe Mirëmbajtja e pajisjeve për navigator të qytetit” e dt.01.10.2008, urdhër-pagesa e MTI-së e dt.17.10.2008 në shumë prej 22.602,60 euro, urdhëri për pagesë e MTI-së e dt.19.12.2008 në shumë prej 90.410,00 euro, fatura PK/13 e dt.17.12.2008 e kompanisë “A.C.” në shumë prej 90.410,40 euro, pro-fatura 01/MTI/08 e dt.14.10.2008 e kompanisë “A.C.” në shumë prej 22.602,60 euro, raporti i auditimit nga komisioni i MTI-së lidhur me projektin navigatori i qytetit i dt.27.06.2011, dosja e tenderit “Furnizimi, Instalimi dhe Mirëmbajtja e pajisjeve për navigator të qytetit” dhe ekspertiza ekonomiko-financiare GJPP.nr.315/2012 e dt.14.01.2013.

Dëshmitari A.S., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë dëshmisë së dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.24.05.2016, dt.18.03.2016 dhe dt.12.02.2016, në të cilat kishte deklaruar se kompania e tij “A.C.” ka qenë fitues i projektit “Navigatori i qytetit”, sa i kujtohet zyrtarët e Ministrisë me të cilët ka kontaktuar kanë qenë Bujar Kuqi, drejtori departamentit të turizmit, m. i projektit H.B., sa i përket të akuzuarit H.B. e ka takuar në cilësinë e zyrtarit të departamentit të turizmit, ndërsa që pas ballafaqimit me deklaratën e dhënë në polici me dt.04.09.2011 ku kishte deklaruar se ka pasur disa takime me tani të akuzuarin H.B., dhe se në njërin nga këto takime i kishte propozuar që të angazhohen bashkarisht për të gjetur fonde për këtë projekt, është përgjigjur se po, kjo është e vërtetë, dhe se në vazhdimësi kanë pasur kontakte me të njëjtin, përfshirë edhe shkëmbimin e numrave telefonik dhe propozimin që i njëjti të angazhohet pranë kompanisë së tij në cilësinë e konsulentit të pavarur. Më tutje ka theksuar se projekti ka qenë i ndarë në 2 pjesë, pjesa e parë ka qenë furnizimi dhe dorëzimi i hardëare-it dhe softëare-it, ndërsa pjesa e dytë ka qenë instalimi në pikat që ka pasur t'i caktoj MTI-ja, e të cilat i ka caktuar pjesërisht, ku edhe janë vendosur kiosqet e

parapara, mirëpo që MTI-ja nuk i ka përmbushur obligimet dhe nuk i ka caktuar të gjitha pikat ku është dashur të vendosën kiosqet. Më tutje, ka shtuar se duke qenë se nuk kanë qenë të caktuara vendet, pajisjet është dashur të dorëzohen në MTI dhe se të njëjtat janë dorëzuar të gjitha sipas kontratës, dhe se pagesa është kryer në bazë të faturës në të cilën është shënuar shuma që duhet paguar. Po ashtu, ka shtuar se nuk e dinë në kuadër të shumës a është përfshirë edhe kosto e vendosjes së 12 kiosqeve nëpër pika, nuk i kujtohet se sipas dosjes së tenderit a është dashur të dorëzohet një plan i implementimit të projektit, derisa i kujtohet se gjatë implementimit të projektit ka pasur vërejtje nga zyrtarët e Ministrisë për mosimplementim të kontratës, dhe se lidhur me këto vërejtje ka vepruar duke ua dërguar personave përgjegjës, mirëpo që nuk i kujtohen emrat e tyre. Më tutje, ka shtuar se iu është paguar e gjithë shuma e kontraktuar, mirëpo që kanë pasur edhe shpenzime shtesë dhe se ata në funksion të realizimit të projektit, i kanë vendosur kiosqet në vende të caktuara, mirëpo të njëjtat janë larguar, ndërsa që është kërkuar nga të njëjtit që të bëjnë kabina shtesë, 7 apo 8. Më tutje, dëshmitari ka sqaruar se fjala instalim në kuadër të ofertës financiare që është dorëzuar me rastin e dorëzimit të ofertës, ka nënkuptuar që pas caktimit të pikave prej MTI-së, sigurimin e rrymës dhe internetit, ka përfshirë pjesën tjetër deri në bërjen funksionale të kiosqeve ka qenë pjesë e kontratës, e që është dashur të kryhet nga operatori ekonomik, ndërsa që shuma prej 20.870,00 euro ka përfshirë instalimin e serverit për administrim dhe shënime në MTI, dhe mirëmbajtja ka përfshirë periudhën kohore prej 12 muajve që është dashur të filloi, pas dorëzimit të pajisjeve. Më tutje ka theksuar se çmimi i caktuar sipas kontratës i është paguar në tërësi kompanisë së tij, mirëpo që pranimi teknik i këtij projekti nga MTI nuk është bërë asnjëherë, ndërsa që edhe njëherë ka sqaruar faktin se tenderi ka qenë i shpallur që kabinat me të gjitha pajisjet të vendosen në 12 pika, por edhe pse janë blerë pajisjet, ka qenë e pamundshme vendosja e tyre për shkak se nuk janë krijuar kushte nga MTI-ja. Në deklarata që ka dhënë në procedurën paraprake, përveç rrethanave që ka përshkruar në dëshminë të shqyrtim gjyqësor, ka përmendur edhe rrethana tjera siç është rasti me deklarata në polici të dt.04.09.2012, ku përveç rrethanave të cekuara më lartë, ka theksuar se dikund në dimrin e vitit 2007, e ka thirrë tani i akuzuari H.B. në telefon, dhe ka kërkuar nga ai që t'ia jap 800 euro, me qëllim që t'a regjistrojë magjistraturën, ndërsa projektin e navigatorit t'a shtyjë përpara, mirëpo që dëshmitari ka refuzuar dhe pastaj pas disa muajve i akuzuari Halil, e ka thirrur nga nr. i telefonit ... dhe ka kërkuar të takohen dikund, dhe janë takuar ku edhe ka informuar se në kuadër të MTI-së do të shpallet një tender për navigatorin. Ndërsa që në pjesën tjetër të kësaj deklarate ky dëshmitar ka dhënë përgjigje të ngjashme me ato të dhëna në shqyrtimin gjyqësor, e po ashtu ngjashëm është përgjigjur edhe në deklaratën e dhënë në prokurori me dt.16.10.2012 lidhur me rrethanat për të cilat është pyetur. Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, dëshmi të cilën e ka gjetur si dëshmi të sinqertë dhe objektive, nga e cila vërtetohet bindshëm fakti që kontrata e lidhur në mes të Operatorit Ekonomik dhe MTI-së, lidhur me realizimin e projektit "navigatori i qytetit", ka përfshirë edhe vendosjen e kabinave dhe funksionalizimin e tyre, dhe se sipas këtij dëshmitari një pjesë edhe janë vendosur, andaj shuma në tërësi e paguar ka përfshirë edhe realizimin e kësaj pjese të projektit, që sipas dëshmitarit shkak për mosrealizim kanë qenë mos krijimi i kushteve për vendosje nga autoriteti kontraktues-MTI-ja. Po ashtu përmes këtij dëshmitari, vërtetohet bindshëm fakti i nivelit të angazhimit të tani të akuzuarit H.B., i cili siç vërtetohet nga ky dëshmitar, edhe e ka njoftuar të njëjtin për projektin "navigatori i qytetit", duke e inkurajuar që të marrë pjesë, me çka vërtetohet se i akuzuari H. siç e ka pohuar edhe vetë në deklaratën e dhënë në prokurori me dt. dt:03.10.2012, ka qenë ideatori i projektit, ndërsa që fakti se paraprakisht e ka njoftuar këtë Operator Ekonomik për projektin, vërteton se edhe në momentin e nënshkrimit të raportit të pranimit të dt.19.12.2008, e ka ditur se Operatori Ekonomik kontraktues, nuk i ka përmbushur obligimet sipas kontratës, por me qëllim që të sigurojë të dobisë pasurore për OE kontraktues, ka nënshkruar raportin e pranimit, i cili edhe ka shërbyer si bazë që OE-së t'i paguhet, shuma e mbetur prej 90.410,40 euro.

Dëshmitarja B.H., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se punon në MTI që nga dt.18.01.2006, në vitin 2008 ka qenë Zyrtare e Lartë në Integritime Europiane dhe nuk i kujtohet diçka lidhur me kompaninë “A.C.” nga Gj.. Ndërsa që e njeh tani të akuzuarin H.B. prej kohës që ka punuar në MTI, ndërsa sa i përket të akuzuarit B.Z. nuk e njeh dhe është e vërtetë se ka dëgjuar lidhur me projektin “Navigatori i Qytetit”, i cili është zhvilluar në kuadër të Departamentit të Turizmit, dhe se është e vërtetë se ka qenë pjesë e komisionit për pranimin e mallrave, mirëpo që në rastin konkret nuk i kujtohet pranimin e ndonjë malli nga firma “A.C.”, përfshirë ndonjë kioskë apo server të kompjuterëve, dhe që edhe pas ballafaqimit me faturën me nr.PP/13 e dt.17.12.2008, ka deklaruar se nuk është nënshkruese e këtij dokumenti dhe nënshkrimi që është i evidentuar aty, nuk është i saj, ndërsa që komisionin e cakton sekretari permanent me vendim në formë të shkruar. Po ashtu edhe në deklaratën që ka dhënë në polici me dt.18.01.2012, ka theksuar se nuk ka marrë pjesë në pranimin e mallit të përshkruar në raportin e dt. 17.12.2008, dhe se nuk është as shkrimi i emrit, mbiemrit dhe as nënshkrimi i saj, dhe se në kuadër të projektit “Navigatori i qytetit”, nuk ka pasur asnjë angazhim. Gjykata ka vlerësuar dëshminë e kësaj dëshmitarje, dëshmi të cilën e vlerëson si të sinqertë dhe objektive, mirëpo përmes së cilës nuk ka vërtetuar ndonjë rrethanë relevante në këtë çështje penale, pasi që siç ka theksuar edhe vetë, kjo dëshmitare nuk ka pasur kurrfarë angazhimi në kuadër të këtij projekti, dhe as që ka qenë pjesë e komisionit për pranimin e pajisjeve të dorëzuara nga OE “A.C.”.

Dëshmitari A.K., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në vitin 2008 ka qenë sh. i kabinetit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, dhe se lidhur me projektin “Navigator i Qytetit” nuk ka dëgjuar, derisa në vitin 2009, është emruar në cilësinë e drejtorit në zyrën e prokurimit, dhe ndërkohë nga Departamenti i Turizmit, i kanë kërkuar disa dokumentacione dhe kur e ka marrë dosjen e tenderit, ka kuptuar lidhur me ekzistencën e të njëjtit, dhe në asnjë mënyrë nuk ka njohuri lidhur me zbatimin e këtij projekti. Më tutje ka shtuar se pas shiqimit të dosjes së tenderit e ka kuptuar se në këtë dosje, nuk janë përfshirë pikat e vendosjes së kabinave dhe se të njëjtat janë caktuar pas dhënies së tenderit, dhe se në dosjen e tenderit nuk ka pasur kosto të veçantë apo shumë të veçantë për vendosjen e kabinave, ndërsa që mënyra e pagesës lidhur me këtë tender ka qenë e ndarë në dy këste. Po ashtu, ka shtuar se gjatë kohës sa ai ka qenë në zyrën e prokurimit, nuk ka marrë asnjë kërkesë për penalizimin e operatorit ekonomik për mospërbushje të kontratës, ndërsa që ka sqaruar se pagesa për operatorin ekonomik lidhur me projektet bëhet në atë mënyrë që projekt-menaxheri e sjell në zyrën e prokurimit faturën, pastaj zyra e prokurimit e dërgon te sekretari permanent, sekretari permanent e dërgon të zyra e financave, që vazhdohet me ekzekutimin e pagesës. Po ashtu edhe në deklaratën që ka dhënë në polici, është përgjigjur në mënyrë të ngjajshme lidhur me rrethanat për të cilat është pyetur. Gjykata po ashtu ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, mirëpo po ashtu të njëjtën e ka gjetur si jo relevante, meqenëse edhe ky dëshmitar nuk ka pasur ndonjë angazhim në kuadër të projektit “navigatori i qytetit”, ndërsa që pohimet e të njëjtit janë të bazuara në dokumentet e dosjes së tenderit, përfshirë edhe kontratën, e që gjykata të njëjtën e ka administruar në cilësinë e provës materiale, andaj pohimet e këtij dëshmitari në këtë drejtim janë jo relevante në vërtetimin e ndonjë rrethane në këtë çështje penale.

Dëshmitari B.K., në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në vitin 2008 ka qenë D. i Departamentit të Turizmit në MTI, se e njeh të akuzuarin H.B. i cili në kuadër të kësaj Ministrie, ka punuar në detyrën e shefit të divizionit në kuadër të Departamentit të Turizmit, ndërsa sa i përket B.Z. ka qenë në dijeni se punon në zyrën e prokurimit të po kësaj ministrie. Më tutje ka shtuar se pas fillimit të punës me dt.05.05.2008, i është paraqitur projekti “Navigatori i Qytetit”, dhe se lidhur me këtë projekt ka pasur vështirësi duke qenë se ka përfshirë të gjitha qytetet e Kosovës, dhe për këtë është dashur të marrin leje prej Komunës, K. dhe P.4, se lidhur me realizimin e të njëjtit është angazhuar tani i akuzuari H.B., dhe se të njëjtin e ka propozuar si mbikqyrës të këtij projekti përmes një komunikimi zyrtar, që i ka dërguar sekretarit permanent të

MTI-së, emri i të cilit nuk iu është kujtuar, e i cili edhe e ka caktuar tani të akuzuarin H. në cilësinë e bartësit të këtij projekti të MTI-së, mirëpo që lidhur me këtë nuk ka pasur vendim me shkrim por vetëm marrëveshje gojore dhe një konfirmim me email, e qëpërkëtë e ka njoftuar edhe ta akuzuarin H., mirëpo qëpërgjigjje lidhur me këtë nuk ka marrur, por i njëjti ka vazhduar membikqyrjen lidhur me implementimin e projektit, angazhimi i të cilit ka konsistuar në angazhimin për të marrë leje nga komunat ku është caktuar për t'u vendosur kiosqet, pastaj kontakti me P.4 lidhur me sigurimin e internetit dhe veprime tjera, dhe se për të njëjtat kohë pas kohe ka njoftuar dëshmitarin lidhur me vështirësit e shumta që janë hasur gjatë implementimit të projektit. Më tutje ka shtuar se projektika përfshirë furnizimin me kabina, montimin e tyre dhe krijimin e bazës së të dhënave dhe është paraparë tëimplementohet në tri faza, dhe se faza e parë e implementimit të këtij projekti ka filluar në vitin 2008 dhe ka vazhduar dhe në vitet në vijim, ndërsa që faza e parë ka përfshirë vendosjen e 12 kabinave dhe bazën e të dhënave për atë projekt, dhe se këto punëështë dashur t'i kryej operatori ekonomik i kontraktuar "A.", disa kabina janë montuar por nuk e ka ditur sa,ndërsa që kjo fazë ka përfshirë shumën prej 100.000,00 euro dhe se kjo shumë e pagesës është kryer, mirëpo që nuk e ka ditur se pagesa e cila është kryer në tërësi, a është kryer sipas kontratës apo sipas punëve të kryera. Më tutje ka shtuar se nuk e dinë se në çfarë cilësie i akuzuari B.Z. ka marrë pjesë në atë projekt, nuk e ka ditur se kush e ka lëshuar urdhëresën për pagesën e këstit të fazës së parë, e as kush ka dhënë urdhër për lëshuarjen e këtyre pagesave, edhe pse ka theksuar se është e mundur që ai të jetë nënshkruar i urdhërit për pagesë, mirëpo që këtë e ka bërë në bazë të raporteve që i janë ofruar.Në deklaratën e dhënë në prokurori dt. 05.03.2012, ka deklaruar se iniciator i projektit ka qenë tani i akuzuari H.B.i cili atë kohë ka qenë udhëheqës i divizionit për politika turistike, qëllimi ka qenë që të vendosen kabinat me informata turistike nëpër vende të ndryshme të Kosovës, dhe se që në fillim ka vërejtur që ky projekt nuk ishte i planifikuar mirë,meqenëse nuk ishin siguruar lejet nga komunat, nuk kishte kontrata me K. dhe P.4 për instalimin e kablove për rrymë dhe internet,dhe se ky projekt ka pasur edhe mangësi tjera të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e tij. Po ashtu ka shtuar se OE-së i është paguar tërë çmimi i kontratës, edhe pse nuk i ka përfunduar obligimet në tërësi nga kontrata, siç ishte vendosja e tërë kabinave dhe mirëmbajtja një vjeçare. Sa i përket të akuzuarit H.B., përveç asaj që ka thënë në shqyrtim gjyqësor se **ai ka qenë bartës i projektit**,ka theksuar se kur ka filluar të neglizhohet realizimi i të njëjtit,është thirrur në faktin se nuk ka pasur vendim për caktimin e projekt – menaxherit.Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, të cilën e ka gjetur dëshmi të sinqertë dhe objektive, e nga e cila ka vërtetuar bindshëm faktin se i akuzuari H.B.ka qenë në cilësinë e projekt menaxherit në projektin "navigatori i qytetit", dhe ani pse nuk ka pasur një vendim në formë të shkruar për caktimin në këtë cilësi, i njëjti ka qenë në dijeni se është caktuar në cilësinë e projekti menaxherit, dhe se në këtë drejtim edhe ka vepruar duke u kujdesur lidhur me implementimin e projektit, përfshirë edhe kontaktet me komunat apo kompanitë e ndryshme publike për ofrimin e shërbimeve të caktuara, dhe se për këtë i akuzuari Halil e ka informuar dëshmitarin në vazhdimësi. Po ashtu nga ky dëshmitar vërtetohet fakti se projekti ka përfshirë edhe vendosjen e kabinave në vendet e caktuar, funksionalizimin e tyre dhe kujdesin një vjeçar për të njëjtat, andaj ky projekt përtej çmimit të kontratës që i është paguar në tërësi, nuk ka përfunduar.

Dëshmitari N.Sh.,në deklaratën e dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në MTI ka filluar punën me dt.16.07.2009, dhe se sa i përket projektit "Navigatori i Qytetit",është informuar se i njëjti ka filluar në vitin 2008, ndërsa që me të njëjtin është ballafaquar atëherë kur ka kaluar me detyrë nëDepartamentin e Turizmit në vitin 2010, dhe se ky projekt në atë kohë ka qenë i ngrirë-i përealizueshëm. Më tutje ka shtuar se ka qenë i formuar një grup punues për rishqyrtim të dokumentacioneve të projektit "Furnizimi, Instalimi dhe Mirëmbajtja e Pajisjeve", i emërtuar si "Navigatori i Qytetit", dhe duke qenë në cilësinë e anëtarit në atë grup, nga kryetari i atij grupi HakiMaxhuni, është obliguar që të hartoj një raport lidhur me objektivat e realizimit të projektit

“Navigatori i Qytetit”. Po ashtu ka shtuar se sa i përket përmbushjes së kontratës, e njëjta nuk është përmbushur në tërësi, dhe se me këtë konkluzion ka arritur në bazë të dokumentacionit që ka shqyrtuar, dhe pas daljes në terren si komision kanë konstatuar se disa kabina janë vendosur, ndërsa disa të tjera kanë munguar, mirëpo që në një pjesë të tyre këto kabina kanë qenë të pakompletuara, dhe se pjesa softëerike nuk ka funksionuar asnjëherë. Më tutje ka shtuar se lidhur me të gjeturat në raport, qëndron plotësisht pas atij raporti dhe deklaratës së dhënë në polici, pasi që në kohën e dhënies së asaj deklarate, memorien e ka pasur më të freskët dhe rrethanat ka arritur t’i përshkruajë në mënyrë më të saktë. Ndërsa qëndë deklaratën e dhënë në polici dt:12.01.2012, ka theksuar se pasi ka ardhë në cilësinë e drejtorit të Departamentit të Turizmit në MTI, është njoftuar se në këtë projekt nuk është punuar për rreth 2 vite, dhe për këtë arsye është formuar një grup punues nga sekretari permanent në kuadër të së cilit ai është autorizuar t’a paraqesë një raport gjegjësisht raportin e dt:06.07.2011, ku ka konstatuar se OE “A.C.”, nuk i ka kryer obligimet konform kontratës, mirëpo që pagesa i është bërë OE-së përkundër moskryerjes së punëve sipas kontratës, ndërsa që nga shkresat është kuptuar se menaxher i kësaj kontrate, ka qenë tani i akuzuari H.B., drejtor i zyrës së prokurimit ka qenë tani i akuzuari B.Z., ndërsa që B.K. ka qenë d. i Departamentit të Turizmit. Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e këtij dëshmitari të cilën e ka gjetur si dëshmi të sinqertë dhe objektive, e nga e cila vërtetohet bindshëm fakti se projekti “navigatori i qytetit” nuk ka përfunduar, pavarësisht se lidhur me të njëjtin është paguar në tërësi çmimi i kontratës, dhe se në kuadër të projektit është përfshirë edhe vendosja e kabinave dhe funksionalizimi i tyre, dhe që në rastin konkret, janë vendosur vetëm disa prej tyre, dhe atë jo në gjendje funksionale, ndërsa që në cilësinë e projekti menaxherit lidhur me realizimin e kësaj kontrate, ka qenë tani i akuzuari H.B..

Nga kontrata nr.MTI204-08-064-1.1.1 me titull “Furnizimi, Instalimi dhe Mirëmbajtja e pajisjeve për navigatorë të qytetit” e dt.01.10.2008, vërtetohet se e njëjta është lidhur ndërmjet MTI-së në cilësinë e autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik nsh. A.C., çmimi total i kontratës përfshinë shumën 113.013,00 Euro, periudha e implementimit të kontratës është në kohëzgjatje prej 9 javësh, ndërsa që mënyra e pagesës do të bëhet në dy kiste, dhe atë, kësti i parë prej 20% e çmimit të kontratës, do të bëhet pas nënshkrimit të kontratës dhe dhënies së garancisë së realizimit të kontratës, ndërkaq kësti i dytë, prej 80 % e çmimit të kontratës, pas pranimit përfundimtar të furnizimeve ose shërbimeve, fatura do aprovohen nga Projekt menaxheri, zyra e prokurimit dhe departamenti i financave, ndërsa që pranimi i përkoshëm dhe përfundimtar do bëhet nga projekt menaxheri. Përveç termave të përgjithshëm dhe të veçantë në nenin 25 të titulluar “Inspektimi dhe testimi”, është paraparë që autoriteti kontraktues do të bëjë inspektimin e pajisjeve të ofruara, kohë pas kohe do të bëjë kontrollimin e pajisjeve të instaluara nga kontraktori, softëare-it dhe pajisjeve përcjellëse në përputhje me kontratën. Në pjesën që ka të bëjë me specifikat teknike të kontratës, shuma prej 113.013,00 është paraparë për të mbuluar shpenzimet sikurse janë: një server, përgatitja e programeve softëare-ike, pajisje hardëare-ike të 3 llojeve, kioskë me kabinë gjithsej 12 copë, të cilat duhet të vendosen në vende publike, si dhe përgatitja e bazës së të dhënave dhe informacioneve në kuadër të të cilave është përfshirë informata të përgjithshme për Kosovën dhe qytetet e saj, atraksionet kryesore turistike etj. Gjykata ka vlerësuar edhe këtë provë materiale, e nga e cila ka vërtetuar bindshëm faktin se shuma prej 113.013,00 Euro, ka përfshirë realizimin e projektit në tërësi, pasi që siç parashihet në nenin 25 të pjesës së veçantë të titulluar “Inspektimi dhe testimi”, është paraparë që autoriteti kontraktues do të bëjë inspektimin e pajisjeve të ofruara, kohë pas kohe do të bëjë kontrollimin e pajisjeve të instaluara nga kontraktori, softëare-it dhe pajisjeve përcjellëse në përputhje me kontratën. Po ashtu nga kjo provë materiale, vërtetohet se kusht për pranimin e projektit është miratimi nga projekt-menaxheri, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret, ku i akuzuari H.B. ka nënshkruar raportin e pranimit të dt.19.12.2009, e që ka shërbyer si bazë për pagimin e shumës në vlerë prej 90.410,40 euro Operatori Ekonomik kontraktues

Nga urdhër-pagesa e MTI-së, e dt.17.10.2008 në shumë prej 22.602,60 euro, vërtetohet se lidhur me kompaninë "A.C.", është aprovuar pagesa në shumë prej 22.602,60, tipi i pagesës është këst, mënyra e pagesës është kësh, në xhirollogarinë 1000 4000 7000 0180, e që të njëjtës i është bashkangjitur edhe urdhërblerja e dt. 14.10.2008, dhe po ashtu edhe raporti i pranimit i dt.16.10.2008, i nënshkruar nga zyrtari i pranimit B.K.dhe zyrtari autorizues Ibrahim Krasniqi për avansin në vlerë prej 22.602,60 euro, e në të cilin raport është konstatuar se duke u bazuar në kontratën e lidhur në mes MTI-se dhe OE "A.C.", nëni 26 metoda e pagesës ku parashihet se 20% e vlerës së kontratës, paguhet pas nënshkrimit dhe parqitjes së garancionit për pagesën e avansit. Gjykata ka vlerësuar edhe këtë provë materiale, e nga e cila vërtetohet se në zbatim të kontratës dhe në përputhje me nenin 26, OE-së kontraktues i është paguar 20% e shumës totale të çmimit të kontratës në formë avansi, ndërsa që pjesa tjetër siç parashihet në nenin e lartcekur, duhej të paguhej në përfundim të realizimit të kontratës.

Nga urdhri për pagesë e MTI-së i dt.19.12.2008 në shumë prej 90.410,00 euro, vërtetohet se lidhur me kompaninë "A.C.", është aprovuar pagesa në shumë prej 90.410,00 euro, tipi i pagesës është këst, mënyra e pagesës është kësh, në xhirollogarinë 1000 4000 7000 0180, që të njëjtës i është bashkangjitur edhe urdhërblerja e dt.18.12.2008, dhe po ashtu edhe raporti i pranimit i dt.19.12.2008, i nënshkruar nga H.B. në cilësinë e zyrtarit të pranimit, e në të cilin është konstatuar se për projektin "Navigatori i qytetit", OE "A.C." i ka sjellë pajisjet e projektit në MTI sipas kontratës, të cilat i ka pranuar komisioni i pranimit i MTI-së. Gjykata ka vlerësuar edhe këtë provë materiale, e nga e cila ka vërtetuar bindshëm faktin se tani i akuzuari H.B., në cilësinë e zyrtarit të pranimit ka konstatuar se OE-ja kontraktuese ka sjellur pajisjet sipas kontratës, ani pse sipas kontratës OE-ja ka pasur për obligim vendosjen e të njëjtave, dhe jo vetëm sjelljen e tyre në depot e MTI-së, ndërsa që sipas kontratës askund nuk parashihet sjellja e këtyre paisjeve në MTI, siç konstatohet në raportin e pranimit nga i akuzuari H., ndërsa që fakti se ky raport është nënshkruar nga i njëjti, tregon cilësinë e të njëjtit në kuadër të këtij projekti, ku sipas nenit 31 të kontratës, pranimi i përkoshëm dhe përfundimtar do bëhet nga projekt menaxheri, siç ka ndodhur në rastin konkret nga i akuzuari H.B..

Nga pro-fatura 01/MTI/08 e dt.14.10.2008 e kompanisë "A.C." në shumë prej 22.602,60 euro, vërtetohet tërheqja e avansit nga kontrata nr.MTI204-08-064-1.1.1, ndërsa që nga fatura PK/13 e dt.17.12.2008 e kompanisë "A.C." në shumë prej 90.410,40 euro, vërtetohet kërkesa për pagesë për pajisjet dhe softëare-ët nr.MTI204-08-064-1.1.1, e në të cilën janë përshkruar veprimet kontraktore siç janë nr. i kiosqeve të vendosura, 12 në çmim total prej 50.791,80 euro, një server kompjuter në çmim prej 2.000,00 euro, një softëare me harta në shumën prej 16.956,54 euro, 12 kioske licencës në shumë prej 8869,56 euro. Kjo faturë është nënshkruar nga B.I. në cilësinë e k., B.B. dhe D.S. në cilësinë e anëtarve. Gjykata ka vlerësuar edhe këtë provë materiale e nga e cila vërtetohet bindshëm fakti se në obligimin e kompanisë ka qenë edhe vendosja e kabinave, pasi që në faturen e dt.17.12.2008, konstatohet qartë kur përshkruhen veprimet kontraktore fjalët "nr. i kiosqeve të vendosura", e që do të thotë se shuma në vlerë prej 90.410,40 euro, i është paguar OE kontraktuese me pretendimin se janë vendosur kiosket dhe atë në 12 copa, ani pse në raportin e pranimit thuhet se janë sjellur në MTI, dhe se me këtë sipas të akuzuarit H.B. është realizuar kontrata.

Nga raporti i auditimit nga komisioni i MTI-së lidhur me projektin "navigatori i qytetit" i dt.27.06.2011, vërtetohet se me dt.06.07.2011 me vendimin e sekretarit permanent pranë MTI-së E.N. është formuar grupi punues për rishqyrtimin e dokumentacionit të projektit të ashtuquajtur "Furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve për navigatorët e qytetit", e që në kuadër të këtij grupi janë përfshirë H.M. në cilësinë e kryesuesit dhe antarëve M.B., Sh.H., M.H. dhe N.Sh. i cili edhe është obliguar për përgatitjen e një raporti, gjegjësisht këtij raporti i cili është administruar në cilësinë e provës materiale në këtë çështje penale. Raporti në vetvete është një përshkrim i zhvillimit të gjithë projektit që nga faza ideore, i cili thuhet se është iniciuar në vitin

2007, ndërsa qëështë inkomporuar në planin e punës për vitin 2008 nga divizioni për politika dhe marketing, përkatësisht përmes shefit të divizionit tani të akuzuarit H.B.. Në vazhdim të këtij raporti janë përshkruar procedurat e tenderimit, pastaj është konstatuar se kontrata e nënshkruar lidhur më këtë projekt, përfshinë vetëm fazën e parëtë realizimit të projektit, mirëpo që në pjesën ku është trajtuar aspekti financiar i projektit është konstatuar se shuma prej 113.013.00 është paraparë për të mbuluar shpenzimet si në vijim një server, përgatitja e programeve softëare-ike, pajisja hardëare-ike – kioskë me kabinë gjithsej 12 copa (në Prishtinë 4, Prizren 2, Mitrovicë 1, Pejë 1, Gjakovë 1, Gjilan 1, Ferizaj 1 dhe në Han tëelezit 1), si dhe përgatitja e bazës së informacionit. Më tutje në raport (i cili nuk përmban fare numrin e faqeve) është konstatuar realizimi i projektit, vlerësuar nga kushtet e veçanta dhe specifikat teknike, është shumë larg nga kriteret e përcaktuara në kontratë, që në mënyrë të veçantë vërehet në drejtimin që ka të bëjë me përgatitjen e bazës së të dhënave dhe informacioneve dhe programeve softëare-ike. Në përmbyllje të këtij raporti gjatë të cilit tani të akuzuarit H.B., autori i të njëjtit iu është referuar si ideator i këtij projekti, përpiluesi i raportit kërkon falje në qoftë se me përmbajtjen e të njëjtit ka shkakuar ndonjëpaqartësi tek lexuesit. Gjykata ka vlerësuar edhe këtë provë materiale mirëpo të njëjti nuk ja fali besimin pasi që i gjithë ky raport i një natyre krejt përshkruese, që për cilësinë e tij flet mjaftueshëm vetë fakti që në vend të përfundimeve të arritura pas “auditimit” të kryer, është konstatuar kërkim falja e autorit të këtij raporti, për ndonjë paqartësi eventuale, ani pse është vështirë për të kuptuar se çka është qartësuar e ndrikuar përmes këtij raporti. Gjykata vlerëson se referimi tani të akuzuarit H.B. si ideator i këtij projekti, por jo edhe projekt menaxher në kuadër të të njëjtit, është i paqëndrueshëm, pasi qëështë në kundërshtim me vetë dëshminë e autorit të të njëjtit, i cili gjatë dëshmisë së dhënë ka pohuar se qëndorn pranë deklaratave që ka dhënë në procedurën paraprake gjegjësisht në deklaratën e dhënë në polici dt.12.01.2012, ku kishte deklaruar se projekt menaxheri në kuadër të projektit “Navigatori iu qytetit”, ka qenë tani i akuzuari Halil Bajrami. Po ashtu edhe konstatimi tjetër në këtë raport, se kontrata ka përfshirë vetëm fazën e parë të projektit, është i paqëndrueshëm, jo vetëm se është joserioz, duke qenë se thotë se kontrata ka përfshirë vetëm fazën e parë të projektit, ama është konstatuar shuma totale e projektit në këtë kontratë prej 113.013.00 euro, mirëpo po ashtu nga vetë kontrata e administruar në cilësinë e provës materiale por edhe nga dëshmia e dëshmitarit B.K., vërtetohet bindshëm fakti, se realizimi i projektit ka përfshirë edhe vendosjen dhe funksionalizimin e kabinave të përshkruara si në kontratën e referuar më lartë.

Nga këto prova e fakte të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata lidhur me të akuzuarin H.B. ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë të kësaj çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të akuzuarit H.B. manifestohen të gjitha elementet e figurës së veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së, e në mungesë të rrethanave të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale, të njëjtin edhe e shpalli fajtor për kryerjen e kësaj veprë penale.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit H.B., mirëpo tënjëjtën e ka gjetur si jo reale, jo bindëse dhe jo të sinqertë, dhe në kundërshtim me dëshmitë e dëshmitarëve dhe provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, andaj, gjykata nuk e aprovoj mbrojtjen e të njëjtit, duke konstatuar se kjo mbrojtje është e pabazuar, dhe me qëllim të ikjes nga përgjegjësisapenale. I gjithë pretendimi i mbrojtjes ka konsistuar në faktin se i akuzuari H. nuk ka qenë në cilësinë e organit mbikqyres përkatësisht menaxher i projektit “Navigatori i qytetit”, andaj dhe pagimi shumë prej 90.410,00 në kushtet e mospërmbushjessëkontratës, nuk mund t’i atribuohet si përgjegjësi e të njëjtit, mirëpo gjykata këtë pretendim e ka gjetur të pabazuar, pasi që fillimisht nuk është kontestuese se nuk është administruar ndonjëprovëqë do e vertetonte se tani i akuzuari H., është emëruar në cilësinë e projekt-m. me një vendim nëformë të shkruar,

mirëpopërtejkesaj, se i njejt i ka shërbyernë atë cilësi, së pari vërtetohet pjesërisht edhe nga vetë mbrojtja e të akuzuarit H., pasi që derisa në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ai si departament i turizmit, ka dhënë vetëm sygjerime profesionale rreth projektit, në deklaratat që kadhënë në procedurën paraprake, gjegjësisht në deklaratën e dhënë në prokurori me dt.03.10.2012, ka deklaruar se ai ka përpiluar projektin ideor “navigatori i qytetit”, dhe se i ka bërë edhe specifikat teknike të tenderit në bashkëpunim me stafin e divizionit, e po ashtu se ndryshe nga shqyrtimi gjyqësor ku ka deklaruar se ka kërkuar sqarime nga tani dëshmitari B.K., duke i thënë se menaxheri i projektit caktohet në fillim të realizimit të tij dhe jo në përfundim si në këtë rast, në deklaratën që ka dhënë në prokurori me date si më lartë, ka pohuar se nuk e ka kundërshtuar caktimin e të njejt i në cilësinë e projekt-menaxherit, pasi që i është thënë se do të përpilohet vendim i shkruar, ku ai do të emërohet në atë cilësi. Po ashtu ndryshe nga shqyrtimi gjyqësor ku ka pretenduar se nuk ka pasur rol në kuadër të projektit “Navigatoritë qytetit”, në deklaratën që ka dhënë në polici me dt.16-17.01.2012, ka deklaruar se roli i tij në kuadër të këtij projekti ka qenë kujdesi për ecurinë e aspekteve teknike të funksionalizimit të projektit, siç janë kontaktet me komunat, K., P.4, ndërsa qënë deklaratën e dhënë në prokurori me dt.03.10.2012, ka deklaruar se pasi që OEo ja ka filluar me vendosjen e kiosqeve, ai bashkë me punëtorët kanë shkruar me operatorin ekonomik në pikat e ndryshme dhe kanë konstatuar se psh. në Prishtinë janë vendosur 3 kabina, dhe po ashtu kabina janë vendosur edhe në vende tjera, ku është paraparë dhe se gjatë kohës e ka vërejtur se operatori ekonomik nuk është duke i kryer obligimet sipas kontratës, ka intervenuar disa herë duke e informuar dr. B.K. dhe po ashtu ka kontaktuar edhe pronarin e kompanisë A.S. i cili i ka premtuar se do ti përmbushë obligimet e tij. Andaj vetë i akuzuari, ka pranuar se ka kryer punë e projekt menaxherit të projektit, anipse formalisht nuk ka pasur një vendim që i njejt i të jetë emëruar në këtë cilësi.

Ndërkaq, sa i përket të akuzuarit B.Z., nuk është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e kësaj aktakuze, dhe senë veprimet e të njejt i, nuk manifestohen elementet e figurës së veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së. Andaj, mbrojtjen e të njejt i e ka vlerësuar si të bazuar pasi që i njejt i ka vepruar konform detyrave të tij të punës, dhe pasi që i është prezantuar dhe dorëzuar raporti i pranimi të malli i nënshkruar nga menaxheri i projektit H.B., dhe sekretari permanent I.K., dhe nënshkrimi i faturave, të cilat kanë qenë në përputhje me raportin për pranim, e në të cilin është shënuar shuma në vlerë e pajisjeve prej 90,410.40 Euro, dhe duke pasë për bazë vlerën e përgjithshme të kontratës pre 113,013.00 Euro, dhe pagesën e kështit të parë në formë të avansit prej 22,602.60 Euro, i njejt i ka vepruar duke kryer detyrat e tij për procedim të mëtejme në funksion të pagimit të kësaj shume OE-se kontraktuese, dhe se në kërkesën për pagimin e shumës, i janë bashkangjitur të gjitha dokumentet që kanë vërtetuar vlefshmërinë e të njejt i për procedim të mëtejme, kjo edhe për faktin se me kushtet e kontratës nuk është paraparë kërkesë e veçantë për vendosje dhe mirëmbajtje të pajisjeve, si dhe kosto e veçantë për vendosje të këtyre pajisjeve, por vetëm është precizue çmimi i furnizimeve në shumën e përgjithshme të kontratës, e po ashtu duke pasë për bazë edhe afatin e realizimit të kësaj kontrate prej 9 javësh, si dhe faktin se në zyrën e prokurimit nuk është dorëzuar asnjë vërjetje paraprake për mospërmbushje të kontratës, bazuar në një gjendje të tillë të faktve, i akuzuari B.Z., nuk ka ditur dhe nuk ka mundur t’a dijë në bazë të rrethanëve që ka vepruar dhe detyrave që ka pasur, se shumën në vlerë prej 90.410,00 euro nuk duhej paguar OE-së kontraktuese, për shkak se e njejt a nuk ka përmbushur obligimet e marrura me rastin e nënshkrimit të kontratës për realizimin e projektit “Navigatori i qytetit”.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e prokurorisë lidhur me të akuzuarin B.Z., mirëpo të njejt a i ka gjetur të pabazuara pasi që nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar se i njejt i është kryer i veprës penale për kryerjen e të cilës është akuzuar.

Me rastin e vlerësimit të cilat ndikojnë në përcaktimit e llojit dhe lartësisë së dënimit, në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës, gjykata lidhur me të akuzuarin H.B. ka vlerësuar si rrethanë

lehtësuese, padënueshmerinë e tij të mëparme, sjelljen e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale, të qenit familjarë i të njëjtit, kohen e gjatë nga koha e kryerje së veprës penale, ndërsa qërrethana rënduese nuk ka gjetur. Duke i vlerësuar në këtë mënyrë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kjo gjykatë ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësive penale të të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e të njëjtit, si dhe do të përmbajë persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 34 të KPK-së..

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale lidhur me të akuzuarin H.B.do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale, ku në këtë çështje janë mbajtur shumë seanca gjyqësore, si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit , konform neni 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me neni 453 par.1 të KPPRK-së, ndërsa që i akuzuari B.Z. konform dispozitës së neni 454 par 1 është liruar nga shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike në kontest të rregullt civil, është marrë pasi që nga të dhënat si në shkresat e lëndës, dhe kushtet e parapara me kontratë, nuk është specifikuar lartësia e shumës së mjeteve të parapara për vendosje dhe mirëmbajtje të pajisjeve, dhe pala e dëmtuar nuk e ka precizuar kërkesën në mënyrë të qartë, dhe duke mos ia bashkangjitur provat konkrete, ashtu që, të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë lidhur me këtë çështje, konform neni 463 par.1 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.196/13, të dt.14.05.2018

Bashkëpunëtori profesional
Driton Berisha

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
BeqirKalludra

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15ditëve, prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.